



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2024:336715

Datë: 11.02.2025

Numri i dokumentit: 06833300

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr. 4/25

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Minir Hoti, me sekretaren juridike Fatmire Podvorica si procesmbajtëse dhe bashkëpunëtorit profesional Muhamet Musliu në çështjen penale kundër të pandehurit A. Z. për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 pika. 1.4 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.753/2024F, të datës 30.12.2024, në seancën e shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me datë 11.02.2025, në të cilin ishin të pranishëm Prokurori i Shtetit Nazmi Krasniqi, e dëmtuara R. C. dhe i pandehuri me mbrojtësin e tij sipas autorizimit av. B. K., në të njëjtën ditë mori publikisht, shpalli dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri,

A. Z., nga i ati J. dhe e ëma F. e vajzërisë B., i lindur me dt...., me vendbanim në rr "M. Z." në P., ka te kryer shkollën e mesme, profesioni tregtar, i pamartuar, i gjendjes se mesme ekonomike, numri i letërnjoftimit ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE:

Me dt.07.08.2024 në Motel "T. në fsh.Sh. të P. dhe më dt.10.08.2024, në motelin "V." në dhomën vip nr... të O.-it, i pandehuri A. Z., me dashje dhe me qëllim të cenimit të dinjitetit në marrëdhënien familjare ka ushtruar dhunë psikologjike dhe fizike ndaj të dëmtuarës – të dashurës së tij R. C., në atë mënyrë që më dt.07.08.2024 i pandehuri A. Z. e ka dërguar të dashurën e tij në motel "T. në fsh.Sh. të P. ku rrugës deri aty posa kishte hip në veturën e tij e kishte sulmuar fizikisht duke e goditur me grushte në kokë dhe trup ndërsa e në dhomën e motelit e kishte përdorur edhe rripin e pantolonave për ta rrahur ndërsa më dt.10.08.2024 i pandehuri A. Z. me dhunë e ka futur në veturën e tij "Audi" ngjyrë të bardhë me targa zvicerane ... dhe dërgon në motelin V. ku fillon duke përdorur dhunë fizike, duke e goditur me rrip të pantollonave nga ky moment e dëmtuara R. C. kërkon që të shkoj në veturë për ti marr pallomat dhe ikë në

drejtim të kompanisë A. C. ku ka kërkuar ndihmë, e cila ndihet e rrezikuar duke e lajmëruar rastin në polici me ç' rast tek e dëmtuara ka shkaktuar shqetësim të madh emocional, ankth, frike dhe pasiguri për jetën e saj, si dhe lëndime të lehta trupore , -

- me këtë ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 185 par.1 nënpar 1.4 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave ligjore të neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 70 dhe nenit 185 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 364, 365, 368, 369, 449, 452 dhe 462 të KPPRK-së, e:

G J Y K O N

I. ME DËNIM ME GJOBË në shumën prej **1000€ (njëmijë /Euro)**, të cilin dënim i pandehuri detyrohet ta paguaj brenda afatit prej 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

II. Në rast se tani i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë brenda afatit të përshkruar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, atëherë ky dënim me gjobë në kuptim të nenit 43 par. 3 të KPRK-së, do t'i zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që për çdo 20,00 € të dënimit me gjobë, do ti caktohet një ditë burgim.

II. Detyrohet i pandehuri, që në emër të shpenzimeve të procedurës penale për paushallin gjyqësor të paguajë shumën prej **njëzet (20) Euro**, në emër të ekspertizës mjeko ligjore shumën prej **njëzet (20) Euro**, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e Viktimave të Krimit shumën prej **njëzet (20) Euro**, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

III. E dëmtuara R. C. nga P. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civilo juridik.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën PP.II.nr.753/2024F, të datës 30.12.2024, kundër të pandehurit A. Z. për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 pika. 1.4 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka treguar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar më dt.11.02.2024, në të cilën prezantuan Prokurori e Shtetit Nazmi Krasniqi nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, e dëmtuara R. C. dhe i akuzuari me mbrojtësin e tij sipas autorizimit av. B. K..

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar i akuzuari deklaroi: e pranoj fajësinë, i kërkoj shumë falje Ritës, prej atij momenti nuk kemi pasur asnjë problem, i premtoj gjykatës se e dëmtuara nga ana ime nuk do të ket më asnjëherë problem, unë jetoj në Zvicër, e lus gjykatën që të më shqiptoi një dënim të lehtë.

Mbrojtësi i të pandehurit A. Z., av. B. K. lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi: Pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë me vullnetin e tij të plotë, i njëjti i kupton natyrat dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë pa kurrfarë presioni, po ashtu aktakuza është e bazuar në ligj dhe nuk përmban të meta ligjore, kërkoj nga ana e

gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit të vlerësoj rrethanat lehtësuese, dispozitat e nenit 70 dhe 71 të KPRK-së dhe me rastin e shqiptimit të dënimit të i shqiptoi një dënim me gjobë.

E dëmtuara R. C. lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi: Nuk kërkoj kompensim dëmi, nga rasti kut e kam lajmëruar rastin në polici nuk kam pasur asnjë problem, ndërsa sa i përket dënimit le të vendosë gjykata.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar: Nuk e kundërshtojmë pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri A. Z. pasi që një pranimi i tij gjenë mbështetje në provat që janë bashkangjitur aktakuzës dhe i propozoj gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë, të pandehurin ta shpalli fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, lidhur me përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit gjykatës i propozoj që si rrethanë rënduese në rastin konkret të ket parasysh shkallën e lartë të dashjes pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për kryerjen e kësaj veprë penale, faktin se vepra penale është kryer ndaj ish të dashurës së tij, ndërsa si rrethanë lehtësuese gjykatës i propozojmë që të ket parasysh pranimin e fajësisë gjatë këtij shqyrtimi gjyqësorë.

Gjykata pas pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, mbrojtësit të pandehurit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 242 par.2 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve në shqyrtimin fillestar, andaj gjykata konform nenit 242 par.6 të KPPRK-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit, përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së, e për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penal-juridik është përgjegjës, për çka edhe u shpall fajtor dhe iu shqiptua dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se i akuzuari në shqyrtimin fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, ka premtuar se nuk do ta përsëris më veprën, i ka kërkuar falje të dëmtuarës, ndërsa si rrethanë veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti. Andaj gjykata ka ardhur në përfundim se dënimin i shqiptuar të akuzuarit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tyre dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij por ai duhet të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që t'i parandaloj nga kryerja e këtyre veprave

penale dhe të shpreh gjykim shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të gjitha këto të parapara me nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi mbi mundësin e zëvendësimit të dënimit me gjobë, në dënim me burgim është marrë në kuptim të nenit 43 pika 3 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par. 2 pika 2.6 dhe 2.9 të KPPRK-së.

Vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marrë, konform nenit 36 par.3 nën par 3.1 të Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në kuptim të nenit 462 par.1 dhe 2 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal
P.nr. 4/25 dt. 11.02.2025.

Sekretare juridike
Fatmire Podvorica

Gjyqtari i vetëm gjykues
Minir Hoti

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.